



Brückenbauer:innen

Përkrahje për prindërit, mbështetje për fëmijët

Si funksionon shkolla në Basel?

Ku mund të mësojë fëmija im gjermanisht?

Shkolla më shkroi një letër. Çfarë do të thotë kjo?

Unë duhet të punoj - kush do të kujdeset për fëmijën tim?

Fëmija im ka nevojë për një aktivitet gjatë kohës së lirë. Çfarë oferta keni?

Nuk e njoh shumë mirë Baselin. Ku mund të marr informacione?

A dëshironi t'ju ndihmojmë në përgjigjen e këtyre pyetjeve?

Ne mund t'ju këshillojmë dhe ndihmojmë!

Albanisch

Arabisch

Deutsch

Englisch

Franzö-
sisch

Italienisch

Kroatisch

Portugie-
sisch

Spanisch

Tamilisch

Tigrinya

Türkisch



Kush jemi ne? Ne jemi një ekip profesionistësh të trajnuar si ndërmjetësues ndërkulturor dhe punojmë për programin «Brückenbauer:innen» (Urë lidhëset /ët). Ne i njohim të gjitha shqetësimet që kanë të bëjnë me familjen nga historia jonë e migrimit. Ne qëndrojmë pranë jush, ju këshillojmë dhe ju mbështesim në çështjet e rëndësishme për fëmijën tuaj (nga mosha e kopshtit). Ne ju ndihmojmë ta mbështetni zhvillimin e fëmijës tuaj dhe të zhvillonin një bashkëpunim të mirë me shkollën dhe mësuesit.

Çfarë bëjmë ne? Ne takohemi rregullisht me familjet e interesuara, ofrojmë informacione, shpjegojmë sistemin arsimor, shëndetësor dhe social zviceran, ju informojmë për qendrat këshillimore dhe ofertat e përshtatshme dhe ju shoqërojmë gjatë bisedave në shkollë ose në qendra të tjera të specializuara. Ju ofrojmë shërbime të përshtatura sipas nevojave tuaja.

Jeni i interesuar dhe jetoni në Basel-Stadt? Atëherë na telefononi ose na shkruani një email. Ne pastaj do t'ju kontaktojmë. Oferta është në dispozicion në gjashtëmbëdhjetë gjuhë dhe është falas për ju. Ju mund të gjeni informacione të hollësishme në faqen tonë të internetit: www.heks.ch/brueckenbauerinnen

Kontakt: 079 767 76 94 / 079 269 15 98 (Në gjuhën shqipe)

Irene Zwetsch (Në gjuhën gjermane), 061 367 94 48 (të martën dhe të premten gjatë tërë ditës)



HILFSWERK DER EVANGELISCH-REFORMIERTEN KIRCHE SCHWEIZ

Brückenbauer:innen
Pfeffingerstrasse 41
4053 Basel

+41 61 367 94 48
irene.zwetsch@heks.ch
heks.ch